

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

“Për një ndryshim në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, gjatë muajit shtator zhvilloi takime me anëtarët e Komiteteve Rajonale Antitrafik në disa qarqe, ku u diskutua mbi zbatimin e PKV per Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023 si dhe problematikat e adresuara nga pjesëmarrësit shërbyen si udhërrefyes gjatë hartimit të planit të ri kombëtar të veprimit 2024-2025.

Konkretisht:

- Më datë 26 shtator 2023, u zhvillua takimi në Korçë, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, DRSHSSH, NjMF, Fondacioni Kennedy, Misioni Emanuel
- Më datë 11 tetor 2023, u zhvillua takimi në Kukës, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Kukës, Njësitë administrative Bicaj/Surraj/Topojan/Terthore/Shtiqen/Kolis/Malzi, DRSHSSH
- Më datë 12 tetor 2023, u zhvillua takim në Dibër, ku morrën pjesë përfaqësues nga AKPA, Spitali Rajonal DIBër, Bashkia DIBër, Njësitë Administrative Kastriot/Maqellarë/Melan, DRSHSSH, Institucioni i Prefektit, NJVKSH dhe Nisma Arsis
- Më datë 24 tetor 2023, u zhvillua takimi në Vlorë, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Vlorë, DVP, DRSHSSH, SPitali Rajonal Vlorë, DRAKPA, NJVKSH, Këshilli I Qarkut, Prefektura, ZVAP Vlorë-Himarë dhe Qendra Psiko-Sociale Vatra.
- Më datë 30 tetor, u zhvillua takimi në Shkodër, ku morrën pjesë përfaqësues nga Bashkia Shkodër, Prefektura, Bashkia Vau i Dejës, AKPA, Bashkia Malësi e MAdhe, ZVA, DRSHSSH, Malteser Albania

Gjithashtu, më datë 26 tetor 2023, Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, organizoi takimin e anëtarëve të MKR-së, ku u prezantua drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e

interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022”” janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime publike në disa qytete të Shqipërisë.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike) dhe Platformës e-Akte.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin,
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin,
- Ekspertët e jashtëm,
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

--	--	--	--	--